



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 17/102  
Datë: 26.10.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 tetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure*

---

**Koncept Dokument për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës,  
Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit**

Qershor, 2022

## Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit .....	3
Hyrje .....	4
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit .....	5
Kapitulli 1.1. Hyrje në përkufizimin e problemit .....	5
Kapitulli 1.2. Problemi, shkaqet dhe efektet .....	13
Kapitulli 1.3. Palët e interesuara .....	16
Kapitulli 1.4. Zbatimi i acquis së BE-së .....	17
Kapitulli 1.5. Krahasimi me vendet tjera.....	18
Kapitulli 2: Objektivat .....	21
Kapitulli 3: Opsionet.....	22
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim.....	22
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore .....	22
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë - Projektligji i ri .....	22
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme.....	25
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave .....	26
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi.....	27
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve .....	28
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme .....	28
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet.....	31
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm .....	32
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin.....	32
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik .....	33
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore.....	36
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore.....	39
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore.....	41

## Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokument për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Ministria bartëse	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Inspektorati i Ministrisë
Personi kontaktues	Elbasan Shala, 038 200 33208
PVPQ	B11.1
Prioriteti strategjik	Mbetet te formulohet ne takim

Vendimi	
Çështja kryesore	Mbikëqyrja jo efektive
Përmbledhje e konsultimeve	Do të plotësohet pas konsultimit paraprak dhe publik Do të plotësohet pas konsultimit paraprak dhe publik
Opsioni i propozuar	Ligji i ri për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Ndikimet buxhetore do të llogariten më vonë
Ndikimet ekonomike	Ndikimet në koston e ndërmarrjeve dhe në zhvillim ekonomik në përgjithësi
Ndikimet shoqërore	Ndikimet në shëndetin e njerëzve
Ndikimet mjedisore	Ka ndikime të pritshme mjedisore
Ndikimet ndër-sektoriale	Ndikime në të drejtat themelore dhe ndikime jo të drejtpërdrejta në kategori tjerat
Ngarkesat administrative për kompanitë	Ka ndikime në ngarkesat administrative të ndërmarrjeve
Testi i Ndërmarrjet e Vogla dhe te Mesme/Mëdha	Nuk është zbatuar Testi i Ndërmarrjeve te Vogla dhe te Mesme/Mëdha

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i Ligjit të ri për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Afatmesëm	Fuqizimi i kapaciteteve të Inspektoratit të Ministrisë dhe atyre lokale

## Hyrje

Figura1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept dokument për Inspektim në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Ministria bartëse	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Inspektorati i Ministrisë
Personi kontaktues	Elbasan Shala, 038 200 32208
PVPQ	B11.1
Prioriteti strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 Vendimit të Qeverisë Nr.01/56 i dt. 26.01.2022 për miratimin e Planit Strategjik dhe Operacional të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022;
Grupi punues	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Elbasan Shala, zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit për Mjedis, Ujëra, Natyrë në MMPHI/Kryesuese e Grupit Punues</li> <li>2. Safete Kuçi, Inspektore, Inspektor e Mjedisit, MMPHI / Zëvendës Kryesuese e Grupit Punues</li> <li>3. Shkëndije Ballata, Inspektore e Ndërtimit dhe Planifikimit, MMPHI</li> <li>4. Ismet Dervari, Inspektor i Mjedisit, MMPHI</li> <li>5. Vehbi Spahiu, Inspektor i Natyrës, MMPHI</li> <li>6. Shyqeri Dermaku, DMMU</li> <li>7. Ismail Hetemaj, DMMU</li> <li>8. Ali Sefa, AMMK, MMPHI</li> <li>9. Fatmir Azemi, DNPH, MMPHI</li> <li>10. Bekim Brahimaj, Inspektorati për Energji, MMPHI</li> <li>11. Afërdita Avdyli, Inspektorati për Energji, MMPHI</li> <li>12. Hidajete Zhuri, DIEKP, MMPHI</li> <li>13. Florije Kika, Departamenti Ligjor, MMPHI</li> <li>14. Lindita Xhemshiti, Departamenti i Buxhetit, MMPHI</li> <li>15. Fadil Maxhuni, Departamenti i Komunikimit Publik, MMPHI</li> <li>16. Shpresa Sheremeti, Zyrtare për Barazi Gjinore</li> <li>17. Adem Berisha, Zyrtar përgjegjës për organizimin e konsultimeve me palët e interesuara</li> <li>18. Zana Radoniqi, Ministria e Financave</li> <li>19. Adil Bytyqi, Zyra e Kryeministrit</li> <li>20. Erëza Abrashi, Zyra e Kryeministrit</li> <li>21. Adonis Tahiri, Asociacioni i Komunave</li> <li>22. Valbona Gola - Pula, Institucioni i Avokatit të Popullit</li> </ol>
Informata shtesë	/

# Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

## Kapitulli 1.1. Hyrje në përkufizimin e problemit

Inspektimet janë procedura të rëndësishëm për të siguruar zbatimin e legjislacionit. Ato janë procese teknike komplekse që shpesh përfshijnë një numër të konsiderueshëm të autoriteteve dhe ndërmarrjeve, si dhe individëve. Ky Koncept Dokument trajton çështjen e inspektimeve në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit. Këto inspektime në Republikën e Kosovës, përveç fushës së banimit, aktualisht rregullohen me Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit<sup>1</sup> (në tekstin e mëtejshëm 'Ligji në fuqi për inspektoratin' ose 'Ligji në fuqi').

Ky ligj përcakton formën e funksionimit, rregullimit kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorëve të nivelit, qendror dhe lokal, në fushat e lartpërmendura. Në nivelin qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjit në fuqi, është Inspektorati i Ministrisë, ndërsa në nivel lokal janë inspektoratet e komunave. Gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji janë evidentuar paqartësi dhe kontradikta si në procedura ashtu edhe përmbajtje, të cilat do të shpjegohen më poshtë në këtë Kapitull.

Marr parasysh këtë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në planin e saj të punës, për vitin 2021-2022, ka paraparë përgatitjen e Koncept Dokumentit për ligjin e Inspektoratit në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit (në tekstin e mëtejshëm Koncept Dokumenti). Qëllimi i Koncept Dokumentit është ti analizoj këto probleme, duke shqyrtuar të dhëna nga burimet si në vijim:

- 1) raportet analitike – Raporti i vlerësimit *ex-post* i Ligjit të lartpërmendur<sup>2</sup>; Raporti i Rishikimit Funkcional të Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i muajit Dhjetor, 2019 dhe Raporti pasues i muajit Dhjetor, 2020;
- 2) hulumtimi i mëtutjeshëm i legjislacionit në fuqi dhe dokumenteve tjera raportuese dhe të politikave nga grupi punues, dhe
- 3) diskutimet me grupin punues, zbatuesit e ligjit, palët e interesit dhe publikun.

Vlen të theksohet se ky Koncept Dokument hartohet krahas ligjit të përgjithshëm për Inspektime, i cili ka për qëllim krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor për zbatimin e reformës së sistemit të inspektimeve në Republikën e Kosovës, përmes racionalizimit të numrit të organeve inspektuese në administratën shtetërore, sqarimin e kompetencave të tyre përkatëse, përmirësimin, koordinimit dhe unifikimin e procedurave si dhe kërkesave për zhvillimin e inspektimeve nga organet inspektuese në administratën shtetërore dhe nivelin komunal.

Dispozitat ligjore që ndërlidhën me fushat në kompetencë të inspektorateve sipas Ligjit në fuqi, atij qendror ose atyre lokal, janë të përcaktuara në ligjet specifike që rregullojnë këto fusha, të paraqitura në figurën 2 të mposhtme.

Figura2: Ligjet përkatëse në fushën që trajtohen në këtë Koncept Dokument

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën dokumentin apo planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8910">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8910</a>	Inspektorati i Ministrisë për mbrojtjen e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimet hapësinor dhe urbanistik, dhe ndërtimit  Inspektoratet Komunale të mbrojtjes së mjedisit dhe ndërtimit	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.  Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal.
Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2669">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2669</a>	Inspektoratet komunale  Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,  Inspektorati i Ministrisë  Inspektorati Komunal	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal  Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2829">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2829</a>	Inspektorati i Ministrisë  Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal  Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.  Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal.

Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2711">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2711</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal.
Ligji nr.03/L-043 për Parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2635">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2635</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji.
Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716</a>	Inspektorati i Ministrisë Komunat	Inspektimi dhe kontrolli i përputhshmërisë.
Ligji Nr 04/L-110 për Ndërtim	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2833">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2833</a>	Inspektorati i Ministrisë- Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal
Ligji Nr 04/L-174 për Planifikim Hapësinor	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja për Kategorinë 3 të ndërtimeve. Mbikëqyrja për Kategorinë 1 dhe 2 të ndërtimeve.
Ligji Nr. 04/L-134 për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8859">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8859</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja, por nuk ka rregulla të caktuara se si të veprojnë inspektorët dhe masat që duhet të ndërmerren. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal



Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale Mbikëqyrësit e natyrës në zonat e mbrojtura	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal
Ligji Nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2836</a>	Inspektorati Komunal Mbikëqyrësit e natyrës në zonat e mbrojtura.	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal
Ligji Nr. 04/L-062 për Fshatin "Hoçë e Madhe"	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2835">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2835</a>	Inspektorati Komunal Mbikëqyrësit e natyrës në zonat e mbrojtura	Mbikëqyrja e aktiviteteve dhe zhvillimeve.
Ligji nr. 04/1-087 për Parkun Kombëtar "Sharri"	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2866">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2866</a>	Inspektorati i Ministrisë Drejtoria e Parkut Kombëtar	Mbikëqyrja e aktiviteteve dhe zhvillimeve. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
Ligji nr. 04/1-086 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2865">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2865</a>	Inspektorati i Ministrisë Drejtoria e Parkut Kombëtar	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të drejtorisë Mbikëqyrja e aktiviteteve dhe zhvillimeve. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
			Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të drejtorisë

Ligji Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17767">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17767</a>	Ministria dhe Komunitat	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal.
Ligji nr. 03/1-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670</a>	Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji bëhet nga Inspektoratit Komunal përmes inspektorëve të autorizuar të urbanizimit.
Ligji nr. 04/L-147, për Ujërat e Kosovës	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659</a>	Inspektorati i niveli qendror Autoriteti rajonal i Pellgjeve Lumore, Inspektorati në nivele komunale	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal.
Ligji nr. 06/1-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18129">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18129</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit në bashkëpunim me Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës.
Ligji nr. 02/1-102 për Mbrojtjen nga zhurma	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2586">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2586</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë. Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal
Ligji nr. 04/1-197 për Kimikate	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9370">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9370</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.

Ligji nr.03/1-119 për Produktet Biocide	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2640">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2640</a>	Inspektorati i Ministrisë	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
Ligji për Vetëqeverisje Lokale	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530">https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530</a>	Komunat	Ushtrimi i kompetencave vetanake në: planifikimin urban dhe rural; zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit; mbrojtjen e mjedisit lokal; banimin publik dhe të tjera.
Projektligji për Inspektimet	<u>Shënim: Projektligji nuk është publikuar ende</u>	Inspektoratet e ndryshme	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përbarimore dhe plotësim-ndryshimi i tij nr. 05/L-118	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2870</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
Ligji nr. 05/1-087 për Kundërvajtje	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12839</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal
Ligji nr. 05/1-031 për Procedurën Përgjithshme Administrative	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal
			Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë.
			Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të nivelit lokal

Kodi nr. 04/1-123 i Procedurës Penale	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale	Detyrimi për të informuar organet kompetente për çdo shkelje që kualifikohet si vepër penale.
Kodi nr.06/1-074 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413</a>	Inspektorati i Ministrisë Inspektoratet komunale	Rregullon procedurat për ngritjen e procedurave penale
Ligji nr. 06/1-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura	<a href="https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684">https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18684</a>	Ministria	Çdo ndryshim në strukturën e Inspektoratit duhet të bëhet në përputhje me këtë ligj.

Përveç ligjeve të paraqitura në figurën 2, në fuqi gjithashtu janë një numër i caktuar i akteve nënligjore të ndërlidhura me këtë fushë.

Ligji në fuqi përcakton Inspektoratin e Ministrisë në cilësinë e organit ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (aktualisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës). Ky inspektorat, sipas Ligjit, përbëhet nga: Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit; Inspektorati i mbrojtjes së ujërave, Inspektorati i mbrojtjes së natyrës, Inspektorati i planifikimit hapësinor dhe urbanistik si dhe Inspektorati i ndërtimit.<sup>3</sup> Kurse në nivel lokal, Ligji parasheh inspektoratet komunale që organizohen në kuadër të drejtorive komunale sipas fushave përkatëse: Inspektorati komunal i mbrojtjes së mjedisit dhe Inspektorati komunal i ndërtimit.<sup>4</sup>

Inspektimet sipas këtij ligji janë të rregullta- të lajmëruara, jo të lajmëruara (të bazuara në ankesë, incident ose aksident) të jashtëzakonshme dhe kontrolluese (pas lëshimit të paralajmërimeve). Gjatë inspektimit inspektorët kontrollojnë nëse subjektet funksionojnë në përputhje me detyrimet e parapara nga legjislacioni, lejet ose vendimet e lëshuar nga autoriteti kompetent.

Inspektorati në nivel qendror është aktualisht i organizuar në formën e Departamentit, me dy Divizione sipas Rregullores së brendshme të Ministrisë. Dy divizionet në kuadër të Departamentit janë:

- 1) Divizioni për Inspektorat të Mbrojtjes së Mjedisit, Ujërave dhe Natyrës dhe
- 2) Divizioni për Inspektorat të Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor.

Inspektoratet në nivel lokal janë të organizuara në Drejtori të ndryshme, disa komuna kanë drejtori të veçanta për inspektorat, ndërsa në disa të tjera inspektorët janë në kuadër të drejtorive të caktuara pra të shpërndara në disa drejtori.

Komisioni i Ankesave i Ministrisë shërben në cilësinë e organit të shkallës së dytë në procedurën administrative të inspektimit, për vendimet e inspektoratit qendror. Kurse, sa i përket vendimeve të inspektorateve komunale, në kuadër të komunave funksionojnë Komisionet e Shqyrtimit të Ankesave si organe të shkallës së parë, ndërsa Departamenti Ligjor i Ministrisë shërben në cilësinë e organit të shkallës së dytë, në procedurë administrative. (neni 40 ligjit të Inspektoratit)

## Kapitulli 1.2. Problemi, shkaqet dhe efektet

Për të kuptuar në mënyrë më specifike problemin aktual në fushën që trajtohet me këtë koncept dokument, është zhvilluar dhe elaboruar pema e problemit në vijim.

Figura3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

<b>Efektet</b>	Degradimi dhe ndotja e ambientit
	Rreziku i shëndetit dhe sigurisë
	Numri i madhe i ndërtimeve pa Leje
	Ngecjet në zhvillim ekonomik dhe shoqëror
<b>Problemi kryesor</b>	Mbikëqyrja jo efektive
<b>Shkaqet</b>	Mangësitë ligjore
	Mungesa e kapaciteteve

Problemi kryesor në këtë fushë është kategorizuar si mbikëqyrje jo efektive e aktiviteteve në fushën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit.

Kjo ndodh për shkaqe të caktuara. Ato janë grupuar si në vijim: a) mangësitë ligjore dhe b) mungesa e kapaciteteve të inspektorateve.

### a) mangësitë ligjore

Mangësitë ligjore në këtë fushë janë të ndryshme.

Kornizës ligjore, i mungojnë dispozita të qarta ligjore për caktimin e kompetencave në mes të Inspektoratit të nivelit qendror dhe inspektorateve të nivelit lokale. Ka gjithashtu mos-harmonizim në mes të kompetencave, të drejtave dhe detyrimeve, si dhe procedurave të përcaktuara të mbikëqyrjes inspektuese në ligjet e veçanta, në raport me Ligjin në fuqi.

Sa i përket ligjeve në fuqi, është e rëndësishme të theksohet se përveç Ligjit në fuqi për Inspektoratin, edhe ligjet e veçanta<sup>5</sup> parashohin dispozita që rregullojnë kompetencën e mbikëqyrjes dhe kontrollit të nivelit qendror ose lokal, procedurën, të drejtat dhe detyrat e inspektorëve, si dhe palëve të inspektuara. Disa prej këtyre dispozitave ligjore nuk janë në përputhje me Ligjin në fuqi për Inspektoratin.

Pastaj, mbikëqyrja e paraparë inspektuese e inspektorëve të nivelit lokal nga niveli qendror gjithashtu krijon pyetje lidhur me përputhshmërinë e kësaj mbikëqyrje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, ku parashihen kompetencat vetanake të komunave. Tutje, fushëveprimtaria e Ligjit në fuqi është limituese për të arritur efektin e duhur, pasi që

Inspektoratit të nivelit qendror dhe lokal i mungon kompetenca e mbikëqyrjes për banim sipas ligjit në fuqi, ndërsa kjo është përcaktuar vetëm në ligjet e veçanta. Si rrjedhojë, komunat nuk kanë inspektor të banimit, të cilët janë të nevojshme për mbikëqyrjen e administrimit të ndërtesave të përbashkëta, sa i përket për shembull mirëmbajtjes së ashensoreve, parandalimit të zjarreve dhe aksidenteve e çështjeve tjera. Këto probleme që janë reale për zonat urbane të komunave të Kosovës, mbesin pa u trajtuar, ngase inspektorët tjerë ekzistues nuk kanë kompetencë mbi to.

Nga koha e nxjerrjes së ligjit në fuqi për Inspektoratin, janë ndryshuar dhe plotësuar disa ligje të ndërlidhura, si të veçanta ashtu edhe të përgjithshme. Në këtë drejtim korniza ligjore në fuqi nuk është e harmonizuar me Ligjin për Kundërvajtje, për procedurën dhe dispozitat ndëshkimore, si dhe Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative, për procedurën administrative të inspektimit që duhet të zhvillohet në përputhje me atë ligj dhe gjobat administrative. Mungon gjithashtu harmonizimi me Ligjin për Zyrtarët Publik sa i përket pjesës së shkarkimit të inspektorëve, si dhe ligji nuk përcakton ose bën referencë fare për kriteret e zgjedhjes së inspektorëve të nivelit lokal. Dispozitat buxhetore të përcaktuara në Nenin 21 po ashtu nuk janë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.

Aktualisht, Ligji që e rregullon këtë fushë nuk parasheh dispozita për ekzekutimin e vendimeve, në përputhje me Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Përveç dispozitave për përmbarim, ligjit në fuqi i mungojnë gjithashtu dispozita relevante për sekuestrim gjatë procedurës së inspektimit. Një numër dispozitash janë gjithashtu të paqarta ose kanë dykuptimësi. Në Ligjin që e rregullon këtë fushë, mungojnë parimet. Përkufizimet gjithashtu kanë nevojë të rishikohen.

Në këtë drejtim, vërehet gjithashtu mungesa e dispozitave ose udhëzimeve procedurale për bashkëpunim në mes të inspektorateve dhe organeve tjera që kanë rol të caktuar në sigurimin e zbatimit të legjislacionit në fushat që trajtohen me këtë Koncept Dokument. Këtu është fjala për prokurorinë dhe policinë, ku janë të nevojshme udhëzime për të definuar nëse shkelje të caktuara janë të natyrës administrative, kundërvajtëse ose penale. Nga aspekti komunal është ngritur edhe problemi i mungesës së kompetencës së Policisë për të shqiptuar gjoba drejtpërdrejtë në rastet kur has në shkelje, veçanërisht ato mjedisore.

Sa i përket mangësive ligjore, vlen gjithashtu të theksohet se jo të gjitha aktet nënligjore të parapara me Ligjin në fuqi, janë nxjerrë. Aktet nënligjore të cilat nuk janë nxjerrë janë për: Mënyrën dhe procedurat e konfiskimit (Neni 43.2); Formën dhe përmbajtjen e formularit për ndëshkim me gjobë mandatorë nga inspektorati i Ministrisë (Neni 45.2); dhe Formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit inspektorit komunal (Neni 41.3). Këto akte nuk janë nxjerrë për shkak se janë përcaktuar me ligje tjera të veçanta.

Për më shumë, vlen të përmendet edhe fakti se me Ligjin në fuqi parashihet kompetenca e Inspektorit për Planifikim Hapësinor, mirëpo Ligji i veçantë nuk përcakton mbikëqyrjen inspektuese në këtë fushë dhe as dispozita ndëshkimore.

Në ligjin në fuqi mungojnë edhe kriteret për përcaktimin e metodës dhe parimeve objektive për hartimin e programit/planit të inspektimit, si dhe metodës për të kontrolluar nëse instalimet e planifikuara janë inspektuar gjatë vitit.

Inspektimet, siç është cekur më lartë, bëhen edhe në bazë të ankesave të palëve. Mirëpo, inspektoratet nuk kanë metodë objektive për të përcaktuar rëndësinë dhe pastaj prioritizimin e këtyre ankesave. Pra nuk ka kriteret ligjore për të përcaktuar metodën objektive për të bërë dallimin mes ankesave shumë të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme dhe për t'i pasur të gjitha ankesat në një listë ku mund të shihet statusi i secilës ankesë (e kontrolluar, në shqyrtim).

#### *b) mungesa e kapaciteteve*

Inspektoratet i kanë kapacitetet e kufizuara. Fillimisht duhet të përmendet se numri i inspektorëve në përgjithësi është i vogël në raport me kompetencat e tyre dhe detyrat e punës. Inspektoratet i mungojnë shërbimet mbështetëse ligjore, administrative dhe logjistike. Inspektorët gjithashtu kanë mungesë të njohurive specifike dhe kapaciteteve për fusha të caktuara. Disa komuna nuk kanë inspektorat për mjedis. Nuk kanë as inspektorë për mbrojtjen e ujërave (të cilët duhet ti kenë në bazë të Ligjit për Ujëra). Po ashtu nuk kanë as inspektor te banimit e ne disa komuna nuk kanë as inspektor te planifikimit. Fakt shqetësues është gjithashtu se në disa komuna inspektorët për mjedis ushtrojnë edhe detyra tjera. Në shumë komuna, një inspektor kryen inspektime në fusha të ndryshme, që vështirëson efikasitetin e punës. Në përgjithësi emërtimet dhe kompetencat e inspektorëve në nivel lokal kanë dallime të mëdha. Bashkëpunimi ndër komunal i paraparë me ligj të veçantë përdoret pjesërisht.

Inspektoratet ju mungon gjithashtu sistemi i regjistrimit efikas të dokumenteve. Ka vështirësi në përgatitjen e lëndëve për gjykatë dhe mungon sistemi i paralajmërimit për mbikëqyrje inspektuese kontrolluese (atëherë kur mbaron afati i aktit administrativ). Inspektorët për më shumë nuk janë as të ndërlidhur me baza të tjera të të dhënave shtetërore (p.sh. ato të gjendjes civile, agjencinë e rexhistrimit të bizneseve). Procesverbalet hartohen në mënyrë klasike (me dorëshkrim). Sa i përket matjes së emetimeve, vlen gjithashtu të theksohet se një numër shumë i kufizuar i instalimeve monitorojnë emetimet nga burimet e tyre të emetimeve, dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës po ashtu ka kapacitete të limituara në këtë drejtim. Ka mungesë të laboratorëve të akredituar dhe laboratorëve mobil.

#### **Efektet**

##### *a) Degradimi dhe ndotja e ambientit*

Nëse nuk ka mbikëqyrje efektive të aktivitetëve në ambient atëherë si rezultat kemi degradimin dhe ndotjen e ambientit. Kjo është sfidë aktuale me të cilën Kosova ballafaqohet. Kjo vjen në shprehje sidomos me:

- kualitetin e dobët të ajrit;
- menaxhimin e mbeturinave (ku shumica e mbeturinave përfundojnë në deponi që nuk menaxhohen si duhet, ose deponi të paligjshme);
- ndotjen e ujit (nga ujërat e zeza të pa trajtuara nga shkarkimi i tyre);



- ndotjen dhe mirëmbajtjen e dobët të natyrës (ku përfshihen edhe shpyllëzimet dhe prerjet ilegale të drurëve), dhe
- aksidentet industriale dhe kimike (mbeturinat e rrezikshme të minierave, shkarkimet industriale në lumenj dhe deponitë industriale vazhdojnë të paraqesin kërcënime serioze për tokën dhe ujin).<sup>6</sup>

#### b) Rreziku i shëndetit dhe sigurisë

Me mbikëqyrje jo-efektive ndikohet shëndeti dhe siguria, Ambienti i pastër është i rëndësishëm thelbësor për shëndetin dhe mirëqenien e njeriut dhe ekosistemit në përgjithësi. Faktorë si ndotja e ajrit, zhurma, kimikatet e rrezikshme dhe të tjera ndikojnë negativisht në shëndet përmes sëmundjeve që shkaktojnë dhe vdekshmërinë dhe zhdukjes së gjallesave. Rreziqet e ambientit tek njerëzit e rrisin veçanërisht rrezikun e kancerit, sëmundjeve të zemrës, atyre respiratorë, çrregullimeve mendore dhe sëmundjeve të tjera.<sup>7</sup> Infrastruktura e dobët nga ndërtimet, ose mirëmbajtja e dobët e saj, për më shumë cenon sigurinë dhe rrit numrin e aksidenteve.

#### c) Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror pengohet me mbikëqyrje jo-efektive. Ato janë ngushtë të lidhura me ambientin, ngase ambienti është kryesor në rritjen e aktivitetit ekonomik, duke siguruar burime që duhen për të prodhuar dhe ofruar mallra dhe shërbime dhe absorbuar nënproduktet e padëshiruara që e ndotin atë.

### Kapitulli 1.3. Palët e interesuara

Figura e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuar. Gjithashtu tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, Departamentet relevante	Mangësitë ligjore dhe mungesa e kapaciteteve.	Ministria planifikon ti adresoj këto.
Inspektorati i Ministrisë	Mangësitë ligjore dhe mungesa e kapaciteteve	Inspektorati planifikon ti adresoj këto.
Inspektoratet komunale	Mangësitë ligjore dhe mungesa e kapaciteteve.	Inspektoratet planifikojnë ti adresojnë këto.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	Degradimi dhe ndotja e ambientit	Agjencia ndikohet drejtpërdrejtë.
Agjencia për Barazi Gjinore	Përkitazi me efektet gjinore	Analizimi i çështjeve gjinore
Organizatat e Shoqërisë Civile në fushën e mjedisit	Degradimi dhe ndotja e ambientit	OSHC-të duhet të luajnë rol pro aktiv dhe mbikëqyrës në këtë drejtim.
Bizneset	Degradimi dhe ndotja e ambientit  Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror.	Bizneset vuajnë pasojat.
Qytetarët	Degradimi dhe ndotja e ambientit  Rreziku i shëndetit dhe sigurisë.  Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror.	Qytetarët vuajnë pasojat.

#### Kapitulli 1.4. Zbatimi i acquis së BE-së

Kriteret për inspektim në fushën e ambientit janë të përcaktuara në Rekomandimet e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për “Kriteret Minimale për Inspektimet Mjedisore në Shtetet Anëtare”.

Ky është akti i vetëm nga acquis i BE-së që drejtpërdrejt parasheh këto standarde. Qëllimi i tij është të vendos kritere minimale për inspektime të ambientit në Shtetet Anëtare të BE-së. Këto rekomandime përmbajnë kritere për planifikimin, kryerjen, përcjelljen dhe raportimin mbi inspektimet mjedisore. Duke qenë ligj i ‘butë’, këto rekomandime nuk kanë karakter detyrues, por megjithatë Qeveria e Kosovës që synon anëtarësimin e Kosovës në BE, përmes zbatimit të MSA-së, konsideron zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Ligji në fuqi<sup>8</sup> parasheh se Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në mbrojtje të mjedisit, duke harmonizuar aktivitetin e tij me Rekomandimet e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për “Kriteret Minimale për Inspektimet Mjedisore në Shtetet Anëtare”. Edhe pse është kërkesë ligjore që aktivitetet e inspektoratit të harmonizohen me këto Rekomandime si dhe marr parasysh faktin se inspektoratet i marrin parasysh këto rekomandime gjatë punës së tyre, ekziston nevoja që ato të transpozohen edhe më specifikisht në legjislacionin vendor dhe zbatimi i tyre të jetë edhe më efektiv.

## Kapitulli 1.5. Krahasimi me vendet tjera<sup>1</sup>

Për qëllime të këtij Koncept Dokumenti dhe shqyrtimin e opsioneve të mundshme për adresimin e problemit kryesor, janë analizuar sistemet e tri shteteve: Shqipëria, Kroacia dhe Sllovenia. Vlen të theksohet se Inspektorati i Ministrisë, përmes mbështetjes së GIZ, ka përfituar viteve të fundit nga mbështetja profesionale dhe shkëmbimi i njohurive, me kolegët ekspertë nga Shqipëria dhe Sllovenia.

### *a) Shqipëria*

Në Republikën e Shqipërisë, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit është një institucion publik qendror në varësi të Ministrisë së Mjedisit, që ushtron juridiksionin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përmes zyrës së saj qendrore dhe degëve të saj rajonale (qarkut).

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit i Shqipërisë<sup>9</sup> përcakton detyrat dhe funksionet e këtij Inspektorati. Vendimi Nr. 103 i Këshillit të Ministrave, i datës 4 Shkurt 2015, për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e tij përcakton varësinë institucionale, rregullat e organizimit dhe funksionimit, funksionet e inspektimit, dhe numrin dhe juridiksionin territorial të degëve.

Inspektorati shtetëror për mbrojtjen e mjedisit ka këto funksione:

- siguron kontrollin shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin në fuqi;
- siguron përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit;
- përgatit programet vjetore të inspektimit dhe për sigurimin e zbatimit të tyre;
- siguron informimin për publikun për çështjet mjedisore;
- siguron informimin për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit;
- siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore;
- kryen kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur.
- çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Inspektimi për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, për sa i përket tregtimit të produkteve, lëndëve të para, substancave kimike dhe paketimit të kimikateve, si dhe etiketimit të produkteve dhe informacionit që përmban paketimi, lidhur me ndikimet në mjedis, kryhet nga strukturat inspektuese përkatëse, sipas legjislacionit të posaçëm.

Ndarjet dhe organizimi i saj i punës, statusi i punëtorëve të saj dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera përcaktohen në Ligjin për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë. Ligji për Inspektimin përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit dhe të organizimit të institucioneve publike që kanë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat për inspektime, procedurat administrative dhe krijimin dhe funksionet e Inspektoratit Qendror.

Ministria e Mjedisit mbështet funksionimin efektiv të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit por nuk është i përfshirë në funksionimin e aktiviteteve të inspektimit. Me mbështetjen e Inspektoratit Qendror, ministria përcakton: objektivat strategjike vjetore dhe afatmesëm për inspektoratin shtetëror; dhe tregues specifik për efektivitetin dhe cilësinë e punës së inspektimit.

Sa i përket pjesës së kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë dhe standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kjo kryhet nga: Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse, dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Vlen të theksohet se sistemi i inspektimeve në Shqipëri është tërësisht i digjitalizuar dhe funksionon përmes sistemit *online* qendror.

#### b) Kroacia<sup>10</sup>

Në Republikën e Kroacisë, funksionojnë sektorë të ndryshëm të Inspektimit. Më relevante për këtë Koncept Dokument janë: Sektori i inspektimit të ndërtimeve dhe Sektori i inspektimit për mbrojtjen e ambientit. Krahas këtyre sektorëve funksionojnë gjithashtu zyrat rajonale të inspektimit. Këto inspektorate kanë gjithashtu shërbimet mbështetëse administrative dhe ligjore. Inspektorati i ndërtimeve mbikëqyr zbatimin e legjislacionit ndërtimor ndërsa ai për mbrojtjen e ambientit është përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit sa i përket: ndotjes industriale, ndikimit në mjedis, menaxhimit të mbeturinave, mbrojtjes së ajrit, zbatimit të standardeve kualitative dhe atyre teknike të ambientit, zbatimit të masave të mbrojtjes së ambientit, zbatimit të pëlqimeve mjedisore, lejeve mjedisore ose akteve tjera që caktojnë kushtet për operimin e instalimit.<sup>11</sup>

Vlen të theksohet se Ligji i Kroacisë për Mbrojtjen e Ambientit, sa i përket pjesës së inspektimit, përcakton:<sup>12</sup>

- kompetencat e inspektorëve për mbrojtjen e ambientit;
- kushtet për tu caktuar si menaxher, inspektor kryesor, i lartë apo vetëm inspektor;
- përmbajtjen e planit vjetor dhe programit të inspektimeve;
- fushëveprimin e inspektimeve;
- detyrat e të inspektuarve;
- të drejtat e inspektorëve;
- masat e inspektimit;
- dispozitat për ekzekutimin e vendimeve;
- procedurën ankimore;
- veprimet inspektuese në bazë të ankesës;
- raportet vjetore të punës;
- transparencën dhe publikimin e aktiviteteve, dhe

- dispozitat ndëshkimore në rastet kur nuk zbatohen dispozitat e këtij ligji, gjegjësisht pengohet puna ose nuk vepron në bazë të vendimeve të inspektorit.

*c) Sllovenia*

Në Republikën e Sllovenisë, Inspektorati i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor vepron në kuadër të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Detyra e tyre kryesore është kontrolli i pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi në fushën e ambientit dhe planifikimit hapësinor. Inspektorati gjithashtu kryen detyra profesionale dhe administrative në fushën e transportit ndërkufitar të mbeturinave.

Inspektorati ka tri njësi organizative: 1) Njësinë e inspektimit të ambientit dhe natyrës; 2) Njësinë e inspektimit të ndërtimit, planifikimit hapësinor dhe banimit, dhe 3) Njësinë e shërbimeve të përbashkëta ligjore.

Kompetencat e tyre, Inspektorati i ushtron përmes kontrolleve të rregullta, jashtëzakonshme, ri-inspektimeve, procedurave të kundërvajtjes dhe ekzekutimit të vendimeve. Inspektorati gjithashtu kryen veprime të targetuara të kontrollit. Koordinimi me inspektoratet tjera është po ashtu i rëndësishëm në Slloveni, pasi që Inspektorati merr pjesë në aktivitete të përbashkëta me inspektorate tjera, të organizuara nga Këshilli i Inspektimit apo përmes koordinimit rajonal.

Çdo ankesë nga personat fizik dhe juridik trajtohet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Këto kritere që caktojnë prioritetin e trajtimit të tyre janë: rrezikimi i shëndetit dhe jetës së njerëzve, siguria publike ose vlera e pronës.

Në uebfaqen e Inspektoratit të Sllovenisë publikohen dokumente si planet vjetore, dokumentet strategjike, kriteret për prioritizimin e inspektimeve, raportet e punës dhe raporte të veçanta për fusha të caktuara, si dhe dokumente të tjera.

Fakte shtesë për sistemin e Sllovenisë të inspektimeve janë listuar në Raportet e Rishikimit Funkcional të përgatitura nga ekspertët sllovenë dhe të përmendura në hyrje të këtij Koncept Dokumenti.

## Kapitulli 2: Objektivat

Në figurën 5 më poshtë janë listuar objektivat strategjike, ai specifik dhe qëllimi i politikës, sipas këtij Koncept Dokumenti.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivat/Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Objektivi strategjik-	Vendimit të Qeverisë Nr.01/56 i dt. 26.01.2022 për miratimin e Planit Strategjik dhe Operacional të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022; Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025
Objektivi specifik -Deri në fund të vitit 2024, ka rënie prej 10% në vlerat e elementeve që ndikojnë negativisht në ambient <sup>13</sup> dhe rritje të numrit të operatorëve të formalizuar	Sipas këtij Koncept Dokumenti
Qëllimi i politikës - Fuqizimi i inspektorateve	Sipas këtij Koncept Dokumenti

## Kapitulli 3: Opsionet

Grupi punues për hartimin e këtij Koncept Dokumenti ka shqyrtuar tri opsione me synim të arritjes së objektivave, të përcaktuara në Kapitullin 2. Opsioni i parë është opsioni *status quo*, ose opsioni asnjë ndryshim. Opsioni i dytë është opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës ligjore në fuqi. Opsioni i tretë është Ligji i ri i veçantë për inspektimet në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit.

### Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Opsioni i parë i shqyrtuar nga grupi punues është opsioni asnjë ndryshim. Me këtë opsion korniza ligjore për këtë fushë do të mbetet në fuqi si dhe organizimi i inspektorateve do të mbetet i njëjtë. Grupi punues pas diskutimit dhe analizimit të këtij opsioni, vlerësoi se përmes tij, probabiliteti është shumë i madh që problemet e njëjta, të hasura deri më tani, do të vazhdonin të ekzistonin.

### Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Opsioni i dytë i shqyrtuar është opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit. Ky opsion është shqyrtuar në drejtim të mos-ndryshimit të kornizës ligjore, për faktin se Ligji i Përgjithshëm për inspektime pritet të miratohet në të ardhmen e afërt (tash me është miratuar). Opsioni parashihet nxjerrjen e udhëzimeve operacionale për përmirësimin e punës së inspektorëve në të dy nivelet, në raport me nevojat e tyre për të evituar problemet praktike të identifikuara. Ky opsion parashihet gjithashtu rritjen e numrit të inspektorëve në Inspektoratin e nivelit qendror dhe trajnimin e vazhdueshëm të inspektorëve në përgjithësi.

### Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë – Projektligji i ri

Siç u cek më lartë, ligji i përgjithshëm për Inspektime, tani me është në fuqi. Ligji për inspektime ka paraparë një ndër inspektoratet qendrore, edhe inspektoratin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit, i cili edhe parashihet të rregullohet me ligj të veçantë. Në këtë drejtim, me opsionin e tretë shqyrtohet mundësia që krahas Ligji për Inspektime, të hartohet dhe miratohet gjithashtu edhe Ligji i veçantë për inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit.

Kjo bëhet me qëllim të rregullimit të çështjeve të veçanta për këto lloje të inspektimit, të cilat janë në përputhje me parimet dhe procedurën e përgjithshme të paraparë në Projektligjin e cekur si më lartë. Dispozitat e Ligjit të ri gjithashtu nuk zvogëlojnë nivelin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave juridike të subjekteve të inspektimit të përcaktuara në Ligjin e përgjithshëm për Inspektime.

Ligji i ri do të përmbaj edhe referencë për zbatimin e dispozitave të përgjithshme nga Projektligji për Inspektime, për çështje të ndryshme si llojet e inspektimit, listat e kontrollit, kategorizimin e inspektorëve, procedurën e inspektimit dhe të tjera.

Ligji i ri për bazë kryesore do të ketë Rekomandimin e BE-së nr. 2001/331/EC, të cilin do ta transpozoi në mënyrë të plotë.

Përmbajtja e Ligjit të ri do të jetë si në vijim:

#### Inspektoratet dhe fushat e inspektimeve

Ligji i ri do të parasheh Inspektoratin qendror dhe inspektoratet lokale. Inspektorati qendror do të shërbej si Agjenci Ekzekutive në vartësi të Ministrisë të Ambientit, ku organizimi i tij do të përcaktohet me rregullore të miratuar nga Kryeministri, në përputhje me Ligjin për Organizimin e Administratës Shtetërore. Inspektorati qendror përveç inspektorëve profesional të fushës, do të ketë edhe shërbimet e mbështetjes ligjore, administrative dhe logjistike, në përputhje me kërkesat ligjore. Me krijimin e agjencisë parashihen të punësohen Gjithsejtë 17 inspektor, Shërbimi juridik-2 zyrtar, Shërbimi ekonomik 1 zyrtar, Shërbimi për statistika dhe raportim 1 zyrtar dhe Shërbimet logjistike 2 zyrtar. Inspektoratet komunale gjithashtu do të parashihen në Ligj. Ligji do ta bëjë një ndarje të qartë në mes të kompetencave të inspektoratit qendror dhe atyre lokale, dhe përcaktoj fushëveprimin e çdo inspektimi. Inspektorati në nivel lokal (diskutohet me MPL-në, Asociacionin dhe komunat).

Edhe në kuadër të një inspektorati, Ligji i ri do të përcaktoj kriteret për inspektorin kryesor përgjegjës, në rast se një çështje e caktuar është në kompetencë të dy ose më shumë inspektorëve.

#### Dispozitat tjera specifike procedurale

Ligji i ri do të parasheh procedura specifike për inspektime të natyrës së veçantë, aty ku është nevoja, përndryshe do të bëhet referencë për zbatimin e procedurës së përgjithshme të inspektimit, të përcaktuar në Projektligjin për Inspektime. Ligji i ri gjithashtu do të parasheh nxjerrjen e udhëzuesve për nevoja të inspektoratit qendror dhe atyre lokal, për zbatimin e inspektimeve në fushat e përcaktuara në Ligj. Ato do të jenë në formën e procedurave standarde të operimit.

#### Plani dhe programi për inspektime si dhe trajtimi i ankesave

Gjithashtu me këtë ligj do të parashihet procedura, kriteret objektive për përgatitjen dhe përmbajtja e planit dhe programit për inspektime, në fushat që trajtohen me të. Kriter për hartimin e planit të inspektimeve do të merret edhe rrezikun që aktiviteti mund të ketë në mjedis. Kriteret do të hartohen në përputhje me standardet më të mira dhe përshtatshme të njohura në këtë fushë. Këto dokumente do të publikohen sipas kërkesës ligjore të përcaktuar. Gjithashtu, do të parashihen dispozita për kriteret për shqyrtimin dhe priorizimin e ankesave.<sup>14</sup> Në përkufizime do të sqarohet gjithashtu kuptimi i ankesave.

#### Sanksionet

Inspektoratet do të përcaktohen me Ligj si organe me kompetencë ekskluzive për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes, ndaj shkeljeve të identifikuara, në pajtim me Nenin 56 të Ligjit për Kundërvajtje. Po ashtu me Ligj do të përcaktohen edhe gjobat administrative për shkeljet administrative sipas Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative<sup>15</sup> Ato në këtë kuptim do të kenë edhe kompetencën e 'sekuestrimit' apo 'marrjes së sendit', siç përcaktohet me Ligjin e



lartpërmendur<sup>16</sup> dhe ndërmarjen e masave urgjente, siç përcaktohet me Ligjin e përgjithshëm për Inspektime.<sup>17</sup> Gjobat do të jenë gjithashtu pjesë e Ligjit, për rastet kur pengohet ose nuk zbatohen kërkesat ligjore të inspektorit. Ligji i ri do të parasheh mënyrën e depozitimit dhe ruajtjes së këtyre sendeve. Urdhërimi i masave të tjera specifike që i përkojnë fushave të rregulluara me Ligjin e ri, do të parashihet gjithashtu.

Trajtimi i gjobave administrative dhe kundërvajtëse të shqiptuara nga Inspektorët, sidomos për gjobat të cilat nuk paguhen duhet të trajtohen me ligj përmbarimor.

Me Ligjin e ri edhe Policia do të ketë kompetencë për shqiptimin e gjobave të caktuara, në rastet kur has drejtpërdrejtë në kryerjen e kundërvajtjeve të caktuara. Fushëveprimi dhe lloji i këtyre gjobave do të caktohen me ligj primar. Ligji i ri do të parasheh edhe në mënyrë të përgjithshme aspektet e bashkëpunimit me organet tjera dhe parasheh udhëzues për hapat procedural që duhet të ndjekin për ta bërë këtë bashkëpunim efikas.

#### Ekzekutimi i vendimeve

Tutje, Ligji do të përmbaj dispozita për ekzekutimin e vendimeve të Inspektoratit, në përputhje me legjislacionin relevant në fuqi. Do të parashihet në mënyrë specifike zbatimi i detyrimeve financiare si dhe gjithashtu zbatimi i detyrimeve jo-financiare përmes palëve të treta ose përmes gjobave.

#### Publikimi i aktiviteteve

Përveç detyrimit të raportimit vjetor tek Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm, Ligji do të parasheh detyrimin e inspektoratit për informimin e publikut përmes uebfaqes për inspektimet e kryera, çdo tre muaj. Raportimet tre mujore do të përmbajnë informata të caktuara sipas Ligjit, si emri i personave të inspektuar, lokacioni, data, bashkëpunimi me inspektoratet ose organet tjera, gjendja e konstatuar, masat e ndërmarra të inspektimit dhe gjendja me ekzekutimin e masave të ndërmarra.

#### Shfuqizimi

Me Ligjin e ri do të shfuqizohet Ligji në fuqi për Inspektoratin. Gjithashtu me këtë Ligj, do të shfuqizohen dispozitat nga ligjet e veçanta që rregullojnë pjesën e inspektimit dhe që nuk janë në përputhje me Ligjin e ri për Inspektimin në këtë fushë, si dhe Ligjin e ri të përgjithshëm për Inspektime.

#### **Çështjet përcjellëse të Projektligjit të ri**

Korniza ligjore e re do të përcjellët edhe me aktivitete tjera shtesë në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve të inspektorateve, siç janë rekrutimi i inspektorëve shtesë në Inspektoratin e Ministrisë dhe në inspektoratet komunale, ngritja e kapaciteteve në përgjithësi, në të dy nivelet përmes trajnimeve. Vlen gjithashtu të theksohet se aktivitete tjera që kontribuojnë në fuqizimin e inspektorateve, siç është për shembull digjitalizimi, është paraparë me Ligjin e përgjithshëm për Inspektime.

## Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Të tre opsionet do të kenë ndikim ekonomik, kryesisht në koston e ndërmarrjeve dhe në zhvillim ekonomik në përgjithësi
Ndikimet shoqërore	Të tre opsionet do të kenë ndikim shoqëror, kryesisht në shëndetin e njerëzve
Ndikimet mjedisore	Të tre opsionet do të kenë ndikim mjedisor
Ndikimet në të drejtat themelore	Të tre opsionet do të kenë ndikim në të drejtat themelore, kryesisht në dinjitetin e njerëzve, të drejtën për jetë dhe të drejtën për administrim të mirë
Ndikimi gjinor	Ka ndikime jo të drejtpërdrejta
Ndikimet e barazisë sociale	Ka ndikime jo të drejtpërdrejta
Ndikimet tek të rinjtë	Ka ndikime jo të drejtpërdrejta
Ndikimet në ngarkesën administrative	Ka ndikime në ngarkesën administrative
Ndikimi i NMV-ve	Ndikimet në NVM janë trajtuar në kuadër të ndikimeve ekonomike

Vlerësimi i ndikimit të tri opsioneve të shqyrtuara në Kapitullin 3 është bërë kryesisht në aspektin kualitativ ngase vlerësimi në aspektin kuantitativ ka qenë më i vështirë, për shkak të kapaciteteve të limituara. Në këtë drejtim katër fushat në të cilat priten ndikimet kryesore janë: ekonomia, shoqëria, ambienti dhe të drejtat themelore.

Sa i përket ndikimeve ekonomike, ndikimet kryesore të pritshme janë sa i përket koston së ndërmarrjeve për të siguruar pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi. Llogaritja e koston së zbatimit të ligjeve të fushës, që mbikëqyren nga inspektoratet, siç janë listuar në figurën 2 të Kapitullit 1, duhet të bëhet gjatë vlerësimeve qoftë *ex-ante* ose *ex-post* të atyre ligjeve, por supozimi është se me Opsionet 2, dhe sidomos me Opsionin 3, kosto administrative për këto ndërmarrje në përgjithësi do të rritet dhe atë veçanërisht në fushat ku legjislacioni nuk është duke u zbatuar dhe ekziston nevoja për përpjekje shtesë nga ndërmarrjet për pajtueshmëri. Në ato fusha, ku pajtueshmëria është më e lartë, kosto do të jetë e njëjte ose më e vogël. Me Opsionin 1 në përgjithësi kosto për ndërmarrjet do të mbetet e njëjte. Qëndrimi i grupit punues është gjithashtu se rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes, që mendohet se do të arrihet veçanërisht me Opsionin 3, do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe si rrjedhojë atë shoqëror.

Ndikimet shoqërore të pritshme dhe të drejtpërdrejta nga inspektimet efikase dhe efektive janë veçanërisht sa i përket shëndetit. Pra, Opsioni 3 vlerësohet se do të ketë ndikimin më të madh në këtë aspekt, meqë vlerësohet se do të ketë ndotje të zvogëluar të ajrit dhe ujërave, dhe më pak degradim të ambientit në përgjithësi. Me Opsionin 1, do të vazhdonin problemet e njëjta të mbikëqyrjes jo-efektive, që kanë dhe po vazhdojnë të prodhojnë pasoja në shëndetin e njerëzve në Kosovë. Opsioni 2 vetëm pjesërisht mundet të ndikoj pozitivisht në raport me shëndetin.

Ndikimet më të mëdha dhe më të dukshme që priten janë ato mjedisore. Ka një lidhje të drejtpërdrejtë në mes të rritjes së efikasitetit dhe kualitetit të inspektimeve me mbrojtjen e mjedisit. Kjo sepse, kësi lloj inspektime, që priten me Opsionin 3, do të rrisin edhe pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi të fushës. Me Opsionin 1, zbatimi i legjislacionit të fushës do të mbetet i pjesshëm, ndërsa Opsioni 2 do të shënonte përparim në këtë drejtim, por me ndikim dukshëm më të vogël se Opsioni 3.

Përfundimisht, sa i përket të drejtave themelore, vlerësohet se Opsioni 1, që është vazhdimi i gjendjes aktuale, ndikon negativisht në dinjitetin dhe jetën e njerëzve në përgjithësi. E drejta për administrim të mirë, gjithashtu nuk sigurohet me gjendjen aktuale, kjo ngase procedurat e inspektimit janë shumë të paqarta dhe potencialisht ndërmarrjet, që kanë pajtueshmëri më të madhe, mund të pësojnë nga kjo situatë. E drejta për administrim më të mirë, pjesërisht do të përmirësohej me Opsionin 2, për shkak të udhëzimeve operacionale për inspektoratet që parashihet të miratohen, por prapë se prapë mangësitë ligjore të identifikuara (sidomos ato të nivelit primar të legjislacionit) që do të qartësonin procedurat, nuk trajtohen me këtë Opsion. Opsioni 3, që parasheh hartimin e Ligjit të ri, përcjellë me aktivitetet tjera, do të kenë ndikimin më pozitiv sa i përket të drejtave themelore.

#### Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Grupi punues, siç është cekur në hyrje të këtij Koncept Dokumenti, ka përfituar nga analizat e mëparshme të bëra në këtë fushë dhe kryesisht nga vlerësimi *ex-post* i Ligjit në fuqi për Inspektoratin dhe raportet e ekspertëve nga Sllovenia, mbështetur nga GIZ, të cilat kanë ofruar të dhëna të rëndësishme për hartimin e këtij Koncept Dokumenti. Megjithatë, nxjerrja dhe analizimi i të dhënave kuantitative ka qenë më i vështirë, për shkak të kapaciteteve të limituara, që ka rezultuar edhe në analizim në aspekt më të përgjithshëm të disa elementeve në këtë Koncept Dokument.

## Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Komunikimi dhe konsultimi janë pjesë e rëndësishme për ngritjen e kualitetit të analizave në këtë Koncept Dokument. Në këtë drejtim, grupi punues ka planifikuar aktivitetet e konsultimit, të listuar në Figurën 7 më poshtë.

Figura7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon marrjen e opinionëve nga institucionet tjera, zbatuesit e ligjit dhe publiku për këtë Koncept Dokument.						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikator	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara	Të gjitha palët e interesuara	Takim publik (online)	Përmes e-mailit dhe uebfaqes së Ministrisë	Korrik, 2021		Elbasan Shala, MMPHI
Konsultim i institucioneve të Kosovës	Komunat dhe Ministrinë e linjës	Konsultim me shkrim	Përmes e-mailit	Korrik, 2021		Elbasan Shala, MMPHI
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	Përmes e-mailit dhe uebfaqes së Ministrisë	Gusht, 2021		Elbasan Shala, MMPHI

## Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Në Kapitullin 3 janë shqyrtuar tri opsione të mundshme në raport me objektivat e përcaktuara në Kapitullin 2. Në këtë Kapitull, paraqiten planet e zbatimit për opsionet 2 dhe 3, si dhe bëhet krahasimi i të tri opsioneve që provon edhe të arsyetoj

### Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Opsioni 2 është opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit, pa ndryshime ligjore. Plani i zbatimit për këtë opsion është paraqitur në vijim.

Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i Politikës	Fuqizimi i inspektorateve							Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 Vendimit të Qeverisë Nr.01/56 i dt. 26.01.2022 për miratimin e Planit Strategjik dhe Operacional të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022;							
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1 - Deri në fund të vitit 2024, ka rënie prej 10% në vlerat e elementeve që ndikojnë negativisht në ambient dhe rritje të numrit të operatorëve të formalizuar	Outputi 1.1 Udhëzimet operationale të miratuara		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departament i përgjegjës
		Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i udhëzimeve operationale	x	x				Inspektorati i MMPHI dhe inspektoratet komunale
		Aktiviteti 1.1.2 Miratimi i udhëzimeve operationale		x				MMPHI / komunat
	Outputi 1.2 Inspektorët e rekrutuar		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departament i përgjegjës
		Aktiviteti 1.2.1 Rekrutimi i inspektorëve shtesë	x	x				MMPHI / komunat
	Outputi 1.3 Train		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departament i përgjegjës

		Aktiviteti 1.3.1 Trajnimi i përgjithshëm për inspektorët e rinj	x						MMPHI/IKA P/Donatorët
		Aktiviteti 1.3.2 Trajnimet e vazhdueshme për Inspektoratin e Ministrisë	X	x	x	x	x		MMPHI/Donatorët / Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm
		Aktiviteti 1.3.3 Trajnimet e vazhdueshme për inspektorët komunalë	x	x	x	x	x		MMPHI/Asociacioni i Komunave/Donatorët / Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm

Opsioni 3 është opsioni për hartimin dhe miratimin e Projektligjit të ri për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit, dhe ndërmarrjen e aktiviteteve tjera përcjellëse për fuqizimin e kapaciteteve të inspektorateve. Plani i zbatimit i tij është paraqitur në vijim:

Figura9: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i politikës	Fuqizimi i inspektorateve							Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 Vendimit të Qeverisë Nr.01/56 i dt. 26.01.2022 për miratimin e Planit Strategjik dhe Operacional të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022;							
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi Specifik 1 - Deri në fund të vitit 2024, ka rënie prej 10% në vlerat e elementeve që ndikojnë negativisht në ambient dhe rritje të numrit të operatorëve të formalizuar	Outputi 1.1 Korniza ligjore e re e miratuar		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti i përgjegjës
		Aktiviteti 1.1.1 Hartimi i Ligjit të ri për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit	x					MMPHI

		Aktiviteti 1.1.2 Miratimi i Ligjit të ri	x					Qeveria	
		Aktiviteti 1.1.3 Hartimi i procedurave standarde të operimit	x					MMPHI	
		Aktiviteti 1.1.4 Miratimi i procedurave standarde të operimit	x	x				MMPHI	
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departament i përgjegjës	
	Outputi 1.2 Funkcionalizimi i Inspektoratit Qendror në cilësinë e Agjencisë Ekzekutive	Aktiviteti 1.2.1 Hartimi i Rregullores së brendshme të Inspektoratit			x			MMPHI	
		Aktiviteti 1.2.3 Miratimi i Rregullores së brendshme të Inspektoratit			x			Kryeministri	
		Aktiviteti 1.2.4 Rekrutimi i x inspektorëve shtesë në Agjenci dhe stafit tjetër mbështetës				x	x	MMPHI	
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departament i përgjegjës	
		Aktiviteti 1.2.5 Rekrutimi i inspektorëve shtesë në komuna			x	x	x	Komunat	
	Outputi 1.4 Trajnimi i inspektorëve	Aktiviteti 1.4.1 Trajnimi i përgjithshëm për inspektorët e rinj			x	x		MMPHI/ Donatorët / Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm	
		Aktiviteti 1.4.2 Trajnimet e vazhdueshme për Inspektoratin e Ministrit	x	x	x	x	x	MMPHI/ IKAP Donatorët / Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm	

		Aktiviteti 1.4.3 Trajnimet e vazhdueshme për inspektorët komunalë	x	x	x	x	x	MMPHI/IKA P/ Asociacioni i Komunave/D onatorët / Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm	
--	--	--	---	---	---	---	---	--	--

## Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Për krahasimin e tri opsioneve të shqyrtuara në këtë Koncept Dokument është përdorur analiza shumë kriterëshe. Janë tri kritere që janë marr parasysh: 1) kosto e zbatimit të opsioneve; 2) efikasiteti i opsioneve në arritjen e objektivave të Koncept Dokumentit dhe 3) efekti në mjedisin, ekonominë dhe shoqërinë e Kosovës i opsioneve.

Si kriter i parë - kosto, vlerësohet se Opsioni 1 do të ketë koston më të ulët, ndërsa kosto e Opsionit 2 dhe 3 do të jetë përafërsisht e njëjtë.

Si kriter i dytë - arritja e objektivave, vlerësimi i grupit punues është se vlera prej 10% e përcaktuar në objektivin specifik dhe rritja e numrit të operatorëve të formalizuar, mund të arrihet në mënyrë më efektive me Opsionin 3. Edhe opsioni 2 vlerësohet se e arrin këtë objektiv, por më vështirë për vitin e përcaktuar – 2024. Me vazhdimin e gjendjes aktuale, apo opsionin 1, vlerësohet se nuk mund të arrihet objektivin specifik.

Si kriter i tretë – efekti në mjedisin, ekonominë dhe shoqërinë e Kosovës, në Kapitullin 4 të Koncept Dokumentit, janë dhënë argumente kualitative që supozojnë se efektin më pozitiv do ta ketë Opsioni 3.

Marr parasysh, këto tri kritere, grupi punues vlerëson, se Opsioni 3 është më efikas dhe efektive, andaj edhe i rekomandohet Qeverisë për miratim.

Figura10: Krahasimi i opsioneve

Mjeti i krahasimit: Analiza shumë-kriterëshe			
	Opsioni 1: Asnjë ndryshim	Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit	Opsioni 3: Projektligji i ri
Kosto	+	-	-
Efikasiteti në arritjen e objektivave	--	+	++
Efekti në mjedisin, ekonominë dhe shoqërinë	--	+	+++



Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
<b>Përfundimi</b>	Nuk rekomandohet			Nuk rekomandohet			Rekomandohet		

## Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Opsioni i rekomanduar sipas grupit punues është Opsioni 3, hartimi i Projektligjit të ri për Inspektimin në fushën e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit, që do të përcjellët me ndërmarjen e aktiviteteve tjera për ngritjen e kapaciteteve të inspektorateve.

Plani i zbatimit të Opsionit të rekomanduar është paraqitur në figurën 9, më lartë.

### Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Objektivi specifik i këtij Koncept Dokumenti është arritja e caqeve të caktuara deri në vitin 2024. Në atë vit, planifikohet të bëhet vlerësimi *ex-post* i Ligjit të ri, që do të tregon rezultatin e tij në arritjen e caqeve të lartcekura.

## Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës <sup>18</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		x			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		x			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		x			
	A do të detyrohen bizneset të mbylleten?		x			
	A do të krijohen biznese të reja?		x			
	A do të detyrohen bizneset t'i përbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?	x		u	u	u
Ngarkesa administrative	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		x			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		x			

Transporti	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?					x				
	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?					x				
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?					x				
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?	x		u			u			u
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?					x				
	A do të rriten investimet nga diaspora?					x				
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?					x				
	A do të rriten investimet e huaja direkte?					x		u		u
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?					x				
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?					x				
	A do të ulet çmimi i imputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?					x				
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?					x		u		u
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?					x				
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?					x				

Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?				x				
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?				x				
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?				x				
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?				x				
	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?				x				
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?				x				
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?				x	I	I		u
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?				x				

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshtëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës <sup>19</sup>	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x	I lartë/i ulët		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		x			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		x			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		x			
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?	x		u	u	u
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		x			

	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?				x				
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?				x				
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?				x				
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?				x				
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?				x				
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?				x				
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?				x				
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?				x				
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?				x				
	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?					x			
Kultura	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?				x				
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?				x				
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?				x	u	l	u	
	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?				x	l	u	u	
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?				x				
Qeverisja									

	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	x		I	u	u	
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		x				
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		x				
Shëndeti dhe siguria publike <sup>20</sup>	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?	x		I	I	u	
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?	x		I	I	u	
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?	x		u	I	u	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?	x		I	I	u	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?	x		u	u	u	
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?	x		I	I	u	
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x				

	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si moshë, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		x				
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		x				
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		x				
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		x				
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	x		I			u
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		x				

### Shtojca3: Forma e vlerësimit për ndikimet

#### [-]mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani efj.)?	x		I	I	u
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?	x		u	I	u
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?	x				



	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?												
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?	x											u
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?	x											u
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?	x											u
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?	x											u
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?	x											u
	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?	x											u
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?	x											u
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x										u
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?	x											
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?	x											
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?	x											u
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?	x											u
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?	x											u

Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?	x	U	u	u
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?	x	U	u	u
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjatat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?	x	U	u	u
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?	x	I	I	u
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?	x	U	u	u
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?	x	I	I	u
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?	x	I	I	u
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?	x	U	u	u
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?	x	I	I	u
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?	x	I	I	u
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?	x	I	I	u

#### Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?	Numri i organizatave, kompanive dhe/ose ndikimit	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
--	-----------------	-------------------------------	--	---	-------------------------------

		Po		Jo	individëve të prekur		I lartë/i ulët	I lartë/i ulët
		x		x	I	U		
Dinjteti	A ndikon opsioni në dinjtetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	x			I		I	u
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		x					
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		x					
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		x					
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		x					
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		x					
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		x					
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		x					
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	x			U		u	u
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	x			U		U	u
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	x						
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		x					
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësorisë?		x					

	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?				x				
Trajtimi i barabartë <sup>21</sup>	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	x							
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose fetër, moshe ose orientimi seksual)?				x				
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?				x				
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?	x				U		u	u
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?				x			U	u
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?	x				L		I	u
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?				x				
	A ndikohet qasja në drejtësi?	x						I	u